



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës propozon:

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 07/1-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 neneve 4.2, 14 ,nenit 7.2 dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi si dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2020 të miratojë këtë:

### PROPOZIM

#### VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR NDIHMA TË FAMILJEVE NË NEVOJE DHE NEVOJAT TË TJERA TË MENAXHIMIT TE SITUATËS EMERGJENTE NGA PANDEMIA COVID - 19

#### Neni 1.

**NDAHET, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro) për ti mbështetur financiarisht familjet në nevojë në Komunën e Lipjanit si dhe për nevoja tjera me qëllim të menaxhimit të situatës emergjente nga pandemia COVID-19 që ka prekur edhe Komunën e Lipjanit.**

#### Neni 2.

Mjetet e cekura në nenin 1 të këtij Vendimi, do të ndahen nga buxheti i Komunës së Lipjanit për vitin 2020, kategoritë ekonomike si vijon:

**Shërbimet Kulturore (850) kodi i programit (85003):**

Subvencione e Transfere ..... 15,000.00,

**Bujqësia (470) Programi -47003**

Subvencione e Transfere.....15,000.00,

Infrastruktura Publike (180) Programi -18163

Mallra e Shërbime .....10,000.00,

75512 SHËRBIMET REZIDENCIALE – LIPJAN

Mallra e Shërbime.....10,000.00.

**Totali i mjeteve ..... 50,000.00€**

**Neni 3.**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria e Shëndetësisë.

**Neni 4.**

Ky Vendim për shkak të situatës emergjente të shëndetit publik dhe nevojës urgjente për të vepruar hyn në fuqi menjëherë ditën e miratimit

**ARSYETIM**

Per arsyeje te shfaqjes se pandemisë COVID -19, Komuna e Lipjanit është në situatë emergjente dhe me anë te ketyre mjeteve planifikon te ju ndihmohet familjeve me raste sociale dhe te prekura nga ana e ketij virusi ne te gjithë territorin e Komunes se Lipjanit. Këto mjete financiare do te perdoren edhe per qellime tjera te luftimit te COVID – 19 Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi

Nr. 15-060-16496

21.03.2020

Kryetari i Komunës:

Imri Ahmeti

